

Funksioni i togfjalëshave emërorë

Mr. Agim Spahiu

1 prill 2001

Përmbledhje

Në këtë shkrim autori ka marrë në shqyrtim funksionin më themelor të togfjalëshave emërorë në gjuhën shqipe.

Krahas togfjalëshave foljorë, edhe togfjalëshat emërorë në gjuhën tonë kanë një përdorim shumë të gjerë në kuadër të fjalisë e të periudhës. Ata dalin me vlerën e **kryefjalës, të kallëzuesit emëror, të kundrinës, të përcaktorit, të kallëzuesorit, të rrethanorit** etj. T'i shohim disa nga këto funksione me shembuj konkretë:

1 Si kryefjalë

Kur gjymtyra e varur e togfjalëshit është një përemër dëftor, pronor, i pacaktuar, një emër në gjinore e në kallëzore, një emërtim i pandashëm (i përhershëm) etj., si p. sh.: **Kjo mjegull** i ngjan një deti të çuditshëm që hyn e del nëpër gjire. Të dielën që shkoi **im shoq** u ngrit herët. **Çdo fletë** i dukej Vitës lëndinë e gjelbër, çdo gonxhe një e puthur e zjarrtë; **Shumica e burrave** qëndronin në këmbë dhe ndiqnin me admirim lëvizjet e zhdërvjellta të valltarit. **Unë me kryetarin** u shtrimë aty rrëzë vatrës për të marrë një sy gjumë. **Bagëtia e bujqësia** është një nga ato vepra që luajtën rol gjatë Rilindjes për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare; etj.

2 Si kallëzues emëror

Kur gjymtyra e varur e tij është një mbiemër, një emër në gjinore, një përemër pronor, pyetës, i pacaktuar, një togfjalësh i qëndrueshëm frazeologjik etj. P. sh: Vendosija e pushtetit demokratik është **fitorja e madhe** që ka korrur populli ynë. Ideali im është **e ardhmja e njerëzimit**. Unë nuk e di i **cilës ushtri** je ti, sepse asnjëherë nuk i kam njohur rrobat e ushtrive. Të pasnesërmen, kur u kthye në konak ishte **tërë hundë e buzë**.

3 Si kundrinë e drejtë dhe e zhdrejtë

Përfshihen të gjithë ata togfjalësha që u përmenden më parë në funksion të kryefjalës. Por në këtë funksion gjymtyra e parë zakonisht duhet të jetë në rasën kallëzore. P. sh: **Lidhjen Shqiptare të Prizrenit** e marrin edhe të huajt si mbrojtëse të intergritetit të tokave shqiptare dhe të zhvillimit e të ngritjes së kulturës kombëtare. Ai e kishte parë **Majën e Hekurave**. **Lulet e verës** të Naimit i kishte lexuar disa herë. **Mizën e ullirit** e kishte luftuar me sukses; etj.

Këta togfjalësha emërorë të pandashëm mund të përdoren edhe në rasën dhanore duke funksionuar kështu si kundrina të zhdrejta (krahaso: **Lidhjes Shqiptare të Prizrenit...**, **Mizës së Dheut...**, **Majës së Hekurave...**, **Bjeshkëve të Nemuna...** ; etj.).

4 Si përcaktor i një kryefjale, i një gjymtyre emërore të kallëzuesit emëror, i një kundrine, i një përcaktori, i një rrethanori etj.

Me këtë vlerë mund të dalin edhe disa ndërtime të qëndrueshme frazeologjike etj. Shembuj: Ardhja e **këtij kapedani** që nuk shkelte për të mirë në këtë kohë e në këtë anë, sikur na prishi qejfin. Mos janë edhe ndjenjat e **kësaj moshe** si uji i pusit? Në fytyrën e tij **tërë shëndet** u duk **një e qeshur gazmore**. Vajza e shikonte me ata sy **në formë bajameje**. Paskë gjetur një djalë **për kokë të djalit**, moj vajzë; etj.

5 Si ndajshtim i një kryefjale, i një kundrine, i një përcaktori, i një rrethanori etj.

Ja disa shembuj: Lumi **Drini i Bardhë** është burim i madh energjitik. Isha ulur në barlulishten e qytetit **Bajram Curri** dhe po lexoja gazetën **Koha jonë**. etj.

6 Si kallëzuesor

P. sh. Në fillim atentati kundër federalit i ishte dukur **puna më e lehtë**. Këtë ne e quajmë **detyrën tonë internacionaliste**. Fytyrën e kishte **plotë nishane**. Tërë marifeti është t'ia shkëputim masat armikut që të mbetet si peshku pa ujë; Të dija **me një barrë mend** (me kuptimin *shumë të ditur* si frazeologjizëm) etj.

7 Si rrethanor

Me vlerën e rrethanorëve të vendit dalin togfjalëshat e tipit, si: **në këtë botë, nga ai vend, prej asaj shtëpie** etj. ; të kohës, si: **çdo mëngjes, pas pak ditësh, gjer në atë kohë** etj. ; të shkakut, si: **për këtë arsye, për këtë qëllim** etj. ; të lejimit, si: **pavarësisht nga moti i keq / me gjithë motin e keq** etj.

Është karakteristike se në studimet e ndryshme të gjuhësisë e përgjithshme, për dallim nga ato të gjuhësisë sonë, në kuadër të sintagmës nominale (SN), grupit nominal (GN) apo frazës nominale (NP), përfshihen edhe fjalitë me nënrenditje përcaktore lidhore e lidhëzore (p. sh.: Njeriu **që vetëm për vete punon**, është sikur pema **që frut s'lethon**; Lajmi **se do të shpërndahet misri**, doli nga zemra e dheut.); pastaj trajtat e përcjellores së zgjeruar (p. sh.: Boksieri, **duke e ndjekur me sy të nxier**, ...), si elemente që varen nga paraprijësit a nukleuset e tyre emërorë (si p. sh.: fjalët: **njeriu, lajmi, boksieri**). Kjo është vetëm një pikë që tregon se në çështjen e trajtimit teorik të kësaj njësie gjuhësore ndërmjet gjuhësisë shqiptare e gjuhëve të tjera apo gjuhësisë së përgjithshme ka disa pika dalluese, të cilën problematikë jemi munduar ta sqarojmë më gjerësisht në një artikull të veçantë.